



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 129/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Kryesisë së subjektit politik Srpska Kosovsko-Metohijski Stranka (SKMS) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisioneve të Qendres së Votimit dhe Numerimit (QNR) për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Kryesisë së subjektit politik Srpska Kosovsko-Metohijski Stranka (SKMS)

Arsyetim

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga SKMS, me të cilën pretendohet se “*në disa raste gjatë procesit zgjedhor SKMS-ja ka qenë e informuar se numri i votave të vlefshme të numëruara në favor të kësaj partie ka qenë në diapazon prej 829 do 861 vota. Këto dhëna janë të verifikuara në pajtim me procesverbalet nga vendvotimet. Me atë rast nuk janë evidentuar votat të pavlefshme, ose ndonjë formë të votave të kontestuara apo të padobishme*”.

“*Në numrin e votave të cekur më lartë (505) që kanë qenë në favor të SKMS-së nuk janë llogaritur votat me kusht, ku sipas informatave të kryesisë së partisë ka pasur me qindra vota me kusht, dhe në bazë të cilave kjo parti ka fituar më shumë se 1000 vota*”.

“*KQZ-ja ka publikuar, pa ndonjë informim të mëtejshëm për kryesinë e partisë, me datë 20 Janar 2011 ku kanë qenë 505 fletëvotime në favor të SKMS-së*”.

“*Me këtë rast partia është e dëmtuar për më shumë se qindra vota të cilat i ka fituar drejtësisht në zgjedhjet kosovare të datës 12 Dhjetor 2010, prandaj nga PZAP-i*

kërkohet që ta rivlerësoj numrin nga 505 vota të fituara në favor të SKMS-së dhe të sqaroj cili numer është publikuar nga KQZ-ja me 30 Janar 2011”.

“SKMS-së i vjen keq për këtë mashtrim dhe vjedhje të paparë elektorale, dhe pret nga PZAP-i që të vërtetojë numrin real të votave të fituara”.

Sipas parashtruesit të ankesës Srsпка Kosovsko-Metohijska Stranka në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet në Kosovë, kërkon nga PZAP-i që ta vërtetojë numrin e saktë të votave të fituara nga kjo parti në zgjedhjet e përgjithshme në Kosove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

PZAP vlerëson se pretendimet e subjektit politik SKMS në ankesë, janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar asnjë dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër, procesin votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditivit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja të veçante. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 129/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



